



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga diskutimi publik me qytetarët e Kryeqytetit, mbajtur më 25.6.2024, prej orës 10:00.

Në diskutim publik morën pjesë qytetarët: Violeta Hasani, Xhemail Luta, Xhemshit Cakolli, Skender Sylejmani, Ahmet Statovci, Bekim Berisha, Rifat Berisha, Xhevdet Selimi, Sabri Murseli, Ismet Haziri, Skender Mehmeti, Jon Aliu, Qerim Mehmeti, Egzon Gashi, Naim Gashi, Bahri Gashi, Blerina Shala, Nexhat Gashi, Bashkim Gashi, Ragip Lutolli, Qerçiz Lutolli, Dukagjin Vokshi, Burim Krasniqi, Bashkim GASHI, Astrit Hyseni, Jakup Mehmeti, Ali Berisha, Bekim Hamiti, Fatlum Gashi, Besart Peshku, Astrit Gashi, Feriz Krasniqi, Ibrahim Ejupi.

Në këtë diskutim morën pjesë edhe: Përparim Rama, kryetar, Jehona Lushaku - Sadriu, nënkryetare, Krenar Xhaferi, drejtori i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Sibel Halimi, drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Adelinë Sahiti, drejtor e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Arbër Sadiki, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit, Lulëzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Emergjencave, Donika Çetta, drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Bekim Brestovci, drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Donjeta Dragusha, drejtore e Drejtorisë së Bujqësisë.

Takimin me qytetarë e hapi dhe e kryesoi Osman Bllaca, drejtor i Auditimit, njëherit edhe i përcaktuar nga kryetari për udhëheqjen e takimeve me publikun, fillimisht i përshëndeti të pranishmit duke ju dëshiruar mirëseardhje në këtë takim me qytetarë. Në vazhdim ceku se, prej disa qytetarëve kemi marrë disa pyetje e njëre prej tyre është e qytetarit Agron Ramadani, në të cilën thuhet se: në rrugën “Ndue Përlleshi”, te kompleksi Rukolli, në Matin 1, nga vendosja e një “Kick boxi” në një lokal ku gjatë ushtrimeve kemi shumë zhurmë dhe dridhje në vertikalen e objektit nga goditjet dhe është e pamundur të kemi qetësi në ndërtesë nga ora 06:00-10:00 dhe nga ora 17:00 – 22:00, kur mbahen edhe ushtrimet. Kërkojmë që për këtë çështje të na jepet një përgjigje nga ekzekutivi i Komunës.

Përparim Rama, kryetar, fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë diskutim publik. Lidhur me çështjen e ngritur nga qytetari z. Ramadani tha se çdo intervenim që bëhet në objektet e banimi, ka impakt ose pozitiv ose negativ, mundet me u përmirësua ose me u dëmtua dhe intervenimet e tilla që po paraqiten këtu, po shihen qartë se kanë impakt negativ, për arsye se e përçon zhurmën, i përçon problemet në katet e

Faqe 1 nga 8

sipërme, si të tilla nuk lejohen, nuk janë të lejueshme. Ky veprim është problematik dhe si të tillë ne duhet me ditë saktësisht se ku është kjo adresë, se a mundet aty me operua një ekip i kick boxit. Ky lloj sporti për të vepruar në këto hapësira, duhet me qenë në mënyrën më të kontrolluar, si dhe për vendosjen e tij paraprakisht duhet ta marr pëlqimin edhe prej banorëve të asaj ndërtese.

Osman Bllaca gjithashtu tha se nga një banor i lagjes “Tophane” kemi marrë një kërkesë, ku në at kërkesë është paraqitur një shqetësim rreth një shtëpie të vjetër e pa banuar e cila gjindet në rrugën “Vushtrria”, shtëpia me nr. 124. Kjo shtëpi rrezikon të shembet dhe mund të shkaktoj dëme dhe kërkojnë që kjo kërkesë të meret parasysh nga ekzekutivi i Komunës.

Skender Sylejmani, qytetar, njëherit në cilësinë e përfaqësuesit të 77 shtëpive të prekur nga akt-vendimi i kundërligjshëm i eksproprijimit me nr.07465-25/85. Para 18 muajve na janë ringjallur shpresat se do të merreni me problemin e 77 familjeve të lagjes Kodra e Diellit II, me shpresën se do të shfuqizohet pjesërisht akt-vendimi i kundërligjshëm pa kompensim të pronës. Edhe pse kemi pasur disa takime gjatë vitit 2023, me z. Shkëmb Manaj, deri më tani nuk kemi parë ende veprime nga Komuna e Prishtinës. Ne jemi duke u përballur me vështirësi me pronat tona që 25 vjet pas luftës, 14 vjet para luftës, po bëhen 39 vjet dhe askush nuk e ka zgjidhur këtë problem. Ne nuk do të lejojmë asnjëherë që pronat tona të fituara me djersë të trashëguara, të mbeten në pronësi të Komunës së Prishtinës, andaj nuk do ta humbim durimin deri sa të realizojmë të drejtat tona, andaj kërkojmë që kjo çështje të zgjidhet, të na rikthehen pronat tona.

Përparim Rama, kryetar tha se ne jemi duke u marr intezivisht me pronat, po ashtu do të merremi edhe me pronat e juaja dhe do të shohim se deri ku kan arritur procedurat për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Kjo është një çështje komplekse, që mos me marrë një vendim që mandej të kthehet prapë, kështu që ne si ekzekutiv e kemi parasysh gjendjen e këtyre pronave dhe do të shohim se si të veprojmë më tutje.

Një qytetar i lagjes “Bregu i Diellit” (nuk është prezantuar) tha se ne ato prona i kemi tashëguar nga të parët tanë, kështu që unë nuk po e kam të qartë këtë zgjidhe dhe kjo mundet me u bë shumë lehtë nga kadastri, por mendoj se aty janë bërë manipulime me pronat tona.

Dukagjin Vokshi, qytetar, kërkoi të dij nga kryetari në lidhje me marrëveshjen me Termokosit për 5,000,000.00 euro, por sipas deklaratës së z. Bytyqi, drejtor në Termokos ka thënë se, Ministria e Financave duhet të bëjë transferin dhe pastaj të vazhdojë me procedurën.

Po ashtu problemi i mungesës së ashensorëve në disa ndërtesa, ku do të ishte më se e domosdoshme vendosja e tyre në ato ndërtesa si psh në një banesë 7 katëshe në lagjen “Dardania” nuk ka ashensor. Po ashtu edhe në lagjen “Ulpiana” U3, po ashtu ka nevojë me vendosë ashensorin por edhe fasadimin e ndërtesës. Përballë Qendrës së Mjekësisë Urgjente,

në Ulpianë kanë qenë shkallët, tani është mbushur zhavorë, kërkojmë që të hapat ai vend dhe të vendosen prap shkallët. Te “Santea” aty ku parkohen veturat taxi, propozoi që aty të vendosen shtylla me shirit reflektues. Po ashtu mbrapa “Santesë” parkingu i vetura të jet më i koordinuar aty ka një parregullësi me rastin e parkingut të tyre, si dhe kërkoj që të vendost semafori te “Ramiz Sadiku”, aty te “Burger King-u”.

Te rruga “Zagrebi”, tek shkallët e Dragodanit, ku zbresim në fund nuk është bërë si duhet denazhimi dhe si pasojë e kësaj mbliidhet uji. Kërkoj që kjo të evitohet. Po ashtu në këtë vend duhet të vendoset një shirit për këmbësorë.

Te sheshi, aty, kur dalim nga Policia që vazhdojmë lartë, me dal tek Pishat, te Sllovenia Sporti të vendoset një semafor, si dhe kërkoj që të korrigjohen disa kahje të rrugëve si ato te Katedralja, te Albi Mall, etj.

Valbona Makolli, drejtore tha se ne këtë transfer nga aspekti ligjor e kemi kompletuar, e kemi dorzuar në Ministrinë e Financave, mirëpo nuk është nënshkruar asnjëherë nga ajo ditë nga ministri i financave z. Murati dhe ato mjete janë humbëse, sepse kanë qenë grand qeveritar dhe afati për nënshkim ka qenë deri më 24.12.2023.

Florian Dushi, drejtor, lidhur me pyetjen e z. Vokshi rreth parkungut tha se ju si qytetar mund të bëni ankesë në Drejtorinë e Inspeksionit dhe ne si drejtori do të vendosim në kuptimin e drejtë të zbatimit të rregullores për të cilën është fjala.

Blerina Shala, qytetare afër rrugës “Nazim Gafurri”, tha se jemi një lagje pa dalje dhe jemi diku 15 banorë, problemi është se një qytetar aty e ka uzurpuar një pronë e cila konsiderohet se është komunale dhe ai e shfrytëzon për parking privat dhe neve na është pamundësuar që ta parkojm veturën aty. Si mundet një qytetar i thjeshtë me ble atë vend aty kur ne e dimë se është pronë e Komunës.

Violeta Hasani, qytetare tha se janë 18 kioska që përfaqësohen nga shoqata e bizneseve të vogla dhe kanë kërkuar nga kryetari Rama, se a munden me pas një dakordim në mes tyre, çoftë Komuna me i vendosur kioskat e tyre të reja apo me investuar vet personat, sepse ka persona që janë aty dy bashkëpronar dhe çështjen e çirasë nuk e kanë të rregulluar ashtu si duhet. Kërkojmë nga kryetari Rama se a kishte qenë e mundur me e bërë një projekt se si do të funksiononin këto kioska. Po shtu e kam propozuar një sallë sportive diku në zonën tonë për fëmijët e vegjël ose një kënd lojërash, por ende nuk është realizuar.

Fatlum Gashi, banor nga fshati Drenoc, tha se kërkesë kryesore e banorëve të këtij fshati është rregullimi i një fushe të futbollit e që do të ishte më se e domosdoshme për ushtrimin e klubit sportiv Barileva si dhe për fëmijët e këtij fshati. Gjithashtu kanalizimi në rrugën “Çlirimtarët”, nuk funksionon mirë, pasi që nuk është i rregulluar ashtu si duhet. Shqetësim tjetër është edhe mos mbledhja e mbeturinave, dukuri e cila po shkakton pa pastërti dhe ndotjen e ambientit.

Një qytetar (nuk është prezantuar) nga BL e Mramorit, në emër të kësaj bashkësie tha se si këshill i bashkësisë lokale i kemi renditur disa kërkesa, të cilat i kemi jetike dhe me prioritet, si ajo kërkesa për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit sidomos për lagjet Spahiaj, Busi, për funksionalizimin e Zyrës së gjendjes civile, rihapjen e bibliotekës së dy shkollave që është pjesë e bibliotekës “Hivzi Sulejmani”, renovimin e ambulantës së mjekësisë familjare në Mramor, vazhdimi i rrjetit të kanalizimit, vazhdimi i zgjerimit të rrugës kryesore të fshatit e cila ka mbetur në gjysmë, ndërtimin e një çerdheje dhe një këndi të lojërave, pastrimin e rrugëve, pastrimin e varrezave të dëshmorëve, pastrimin e lumit, të ket më shumë linja të transportit publik, zgjerimi i rrjetit të ndriçimit në lagjet të cilat nuk kanë ndriçim, përforcimin e tensionit të rrymës elektrike, etj.

Xhemail Luta, kryetar i BL të lagjes “Arbëria” falënderoi ekzekutivin e Komunës për të gjitha ato projekte që janë realizuar në këtë lagje.

Bahtir Islami, banor nga fshati Keqekollë, tha se lagja “Spahiaj” për shkak të mos rregullimit të rrugës pothuajse ka mbetur e izoluar dhe kjo si pasojë e neglizhencës së udhëheqësve komunal të mëparshëm, duke filluar nga Ismet Beqiri dhe Isa Mustafa. Po ashtu në këtë fshat për shkak të mos funksionimit të rrugëve është mbyllur edhe shkolla, nuk kemi rrymë me rregull, kështu që kërkojmë që këto kërkesa të merren parasysh nga Komuna.

Ali Berisha, banor nga fshati Siqevë tha se i kam dy kërkesa, njëra për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe tjetra për Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

Në Drejtorinë e Investimeve Kapitale kemi bërë kërkesë për rregullimin e kanalizimit por ende nuk ka filluar projekti.

Po ashtu këtij fshati i mungon transporti publik, një kërkesë e kahmotshme e këtij fshati që deri më tani nuk është realizuar.

Feriz Krasniqi, banor i ish- lagjes “Ramiz Sadiku” tha se objektet e kësaj lagjeje janë të vjetra dhe me rastin e reshjeve atmosferike këto shtëpi vërshohen nga uji dhe rrezikohet jeta e banorëve. Ne si banor të kësaj lagjeje nuk mundemi të investojmë në këto objekte pasi që parcelat toksore janë pa pronar dhe është një kontest i pa zgjidhur mes AKP-së dhe Komunës për definimin e këtyre parcelave. Si banor të kësaj lagjeje kërkojmë që të bëhet një zgjidhje, të na jepet një përgjigje se si të veprojmë më tutje.

Krenar Xhaferi, drejtor tha se ne si drejtori e kemi angazhuar një ekip mobil me i pastrua komplet pusetat që për shkak të vërshimeve me qenë aty tërë kohën, kështu që mos me atakua më vërshimet në atë lagje, me realizimin e projektit të kanalizimit nga lagja “Muhagjerët”, kah Hotel Grandi dhe deri tek ish- Rilindja, kjo gjendje do të sanohet.

Qerim Mehmeti, qytetar, në cilësinë e drejtorit të firmës NTSH Valoni, transport nder-urban, Prishtinë - Sharban tha se, është një kompani tjetër që punon në linjën Prishtinë -

Sharban është vijë lokal që bënë vend ndaljet në Komunën e Podujevës dhe dua të dijë se, a ka të drejt t'i bëjë vend ndaljet në Komunë të Podujevës, kur është si vij lokale e trafikut urban, ndërsa unë jamë në vijën ndër urbane dhe mua ky veprim i tuj më pengon në ushtrimin e kësaj veprimtarie. Për këtë veprim të tij, unë kam bërë ankesë por deri më tani nuk kam marrë ndonjë përgjigje nga Komuna.

Astrit Gashi, qytetar nga lagja "Velania" tha se neve na është premtuar një rrugë që lidhet prej çerdhes së fëmijëve e që del deri tek rruga e Matit dhe deri më sot kjo rrugë nuk është përfunduar. Po kjo lagje e ka edhe një problem i cili ka mbetur shkaku i ndryshimeve që kanë ndodhur, ku të gjitha pronat atje janë në emër të pronarëve, mirëpo nuk është harmonizuar pjesa grafike me pjesën tekstuale. Kërkoj të dijë se a do të bëhet harmonizimi i këtyre parcelave edhe me pjesën grafike.

Ismet Haziri, qytetar, fillimisht me diskutimin e tij u përqendruar rreth sigurisë së qytetarëve i cili tha se, përse nuk dalin policia kur ka vozitje të shpejtë tek zona e Zllatarit, zona e Gërmisë, zona e Veternikut si dhe në zona të tjera, ku ne jemi të rrezikuar nga shpejtësia. Po ashtu Parku i Gërmisë nuk po menaxhohet mirë, së pari tualetet nuk janë në nivelin e duhur, si dhe si shqetësim është edhe lëvizja e motoristëve të cilët hyjnë në stazën e shëndetit, në stazën familjare, andaj kërkoj nga Komuna se si të parandalojmë këtë veprim të tyre. Gjithashtu kërkoj të dijë se çka është duke ndodhë me hapësirat publike, që këto hapësira duhet të kthehen në shërbim të të rinjve, ku në mungesë të tyre nuk mundemi të zhvillojmë aktivitetin nga Grandi deri tek Kuvendi i Kosovës.

Burim Krasniqi, banor nga Hajvalia, anëtar i KLSP-së, dhe përfaqësues i organizatës "Play for Peace", tha se i kemi disa kërkesa, në emër të qytetarëve të Hajvalisë dhe komunitetit kërkojmë të dijmë se, ku ekzistojnë pronat publike që aty të ndërtohet një çerdhe publike, një park, një shtëpi të kulturës, si dhe një lokacion për varreza. Renovimi i rrugës "Dëshmorët e Gollakut" ka mbetur në gjysmë, pastaj është sinjalizimi i rrugës dhe emërtimi, po ashtu një problem që vlen të veçohet është edhe shpejtësia e veturave në rrugët dytësore, si dhe dukuri të tjera negative dhe për evitimin e këtyre parregullësive kemi dorëzuar një kërkesë që të vendost një nënstacion policor.

Jakup Mehmeti, qytetar nga lagja "Muhaxherët" tha se, përball shkollës Naim Frashëri, aty te policia, pse nuk lirohet ajo rrugë dhe ne si banorë jemi të kufizuar nga mos lirimi i saj. Disa gërmime të cilat po bëhen në Sofali, kryesisht prej Laures, aty ka filluar të rrënohet kodra, nuk kam parë ndonjë shenjë që Komuna kryen punime aty dhe neve na është ngushtuar shtegu, për shkak që po rrënohet ajo kodër për zgjerim të rrugës.

Xhevdet Selimi, banor nga fshati Nishec, tha se rruga jonë është 1800 metra dhe kemi kërkuar vetëm zhavorrim e saj, kam investua atje me bletë dhe me pemë 2 hektar, çdo herë kemi qenë në Komunë që me na e rregulluar këtë rrugë por deri më tani nuk është rregulluar.

Bekim Hamiti, banor nga fshati Bërnice e poshtme, tha se, emërtimi i rrugës në këtë fshat është në emër të fqinjit dhe kemi bërë kërkesë me gjithë nënshkrimet e lagjes që emri i kësaj rruge të ndrrohet dhe të emrohet me emrin e të ndjerit Hizdri Gubetini. Gjithashtu rruga “Kreshnikët” që disa vite nuk është duke u mirëmbajtur ashtu si duhet, ambulanta në Bardhosh, me u transformua në QKMF dhe me punua edhe të shtunave dhe të dielave.

Skënder Mehmeti, qytetar nga Prishtina tha se një ri-parcializim që ka ndodhur në Prishtinën e Re, zona perëndim, konkretisht tek lagja “Qëndresa” ka më se 11 vjet nuk është marrë askush me atë pjesë duke i pritur hartat zonale. Kërkoi të dij se a është ndërmarrë diçka konkrete në këtë drejtim, pasi që aty po bëhen ndërtime pa leje dhe unë jam njëri nga qytetarët që kam pritur që 11 vite, me u zgjidh ky problem.

Arbër Sadiku, drejtor tha se sa i përket ri- parcializimit të kësaj pjese, është iniciuar rishikimi i planit dhe ne në mbledhjen e radhes së Kuvendit do të bëhet edhe aprovimi i vendimit i cili e shfuqizon atë pjesë të ri-parcialimit i cili është kusht për të lëshuar lejet ndërtimore.

Astrit Hyseni, qytetar nga lagja “Dardania”, parashtroi këto pyetje: Hapjen e Kroit të Bardhë që është i mbyllur që një kohë të gjatë nuk është duke funksionuar; Largimin e kombi-busëve në lagjen “Vushtrria” që është shqetësuese për ne; Inspektimi i ndërtesave të vjetra, sepse ato rrezikohen që të shemben dhe paraqesin rrezik për qytetarët..

Besart Peshku, banor i fshatit Barilevë tha se lagja “Kurti” ka mungesë të ujit, kemi bërë kërkesa disa herë në Ujësjellës mirëpo nuk kemi pasur përgjigje, por është problem se ujin duhet me marrë prej një lagjes së Komunës së Obiliqit, mirëpo pompat të cilat e dërgojnë ujin janë në territorin e Komunës së Podujevës, d.m.th është një udhëkryq në mes 3 komunave dhe nuk kemi marrë përgjigje, por dua të di se a mundemi ne si komunë me shty përpara si proces duke marrë parasysh se në atë lagje janë mbi 30 shtëpi.

Ibrahim Ejupi, banor afër shkollës “Emin Duraku” tha se që nga viti 2019 e kemi dorëzuar një petition për ngritje të koeficientit, sepse përball nesh te ish kryetari Mustafa është koeficienti 4 ose mbi 4 dhe dua të dij se çfarë po ndodhë me atë pjesë, sepse kemi mbetur si geto e vogël e Prishtinës.

Një qytetar (nuk është prezantuar) nga lagja “Kalabria”, tha se koeficientit që ishte në 1.5 dhe është bërë 2.4, mua aty në lagje më është bërë padrejtësi, pasi që për mua ka mbetur i njëjti 1.5. Kërkoi të dij arsyen pse për fqinjët e mi 2.4 ndërsa për mua 1.5.

Arbër Sadiku, drejtor tha se sa i përket koeficientit në lagjen “Dardania”, është pjesa më periferike se dikur ka pasur koeficient 0.8, që ka qenë për banim individual, pra pjesa e cila lidhet me unazën, komplet ai bllok është me koeficient 1.5.

Përparim Rama, kryetar tha se sa i përket koeficientit në këtë lagje, mendoj se ka qenë një përmirësim i dukshëm, me atë që ka qenë më përpara, sepse përpara ka qenë e pazbatuar, nuk ka pasur një analizë substanciale, pa vizatime pa asgjë dhe tash janë të gjitha dhe ajo vlerë që do ta keni me koeficientin 1.5, është mundësia për të ndërtuar metra katror me të gjitha funksionet që ju jepen si rezultat i një planifikimi të ri.

Një qytetar (nuk është prezantuar), kryetar i këshillit lokal Arbëria 2, përdryshe nga “Përroi i Njelmët”. Si banor i kësaj zone që lidhet me magjistralen Prishtinë – Mitrovicë dhe del në rrugën për Fushë Kosovë tha se, kisha preferuar që këto rrugë të rregullohen dhe të aktivizohen 30 hektar tokë që munden me u bërë për biznese, kryesisht rregullimi i një rruge në gjatësi prej 1.2 km, e cila rrugë do ta shkarkonte në masë komunikacionin edhe e funksionon zonën ekonomike ashtu siç duhet.

Venhar Morina, banor i lagjes Ulpiana, falënderoi ekzekutivin e Komunës për rregullimin e infrastrukturës në përgjithësi në këtë lagje.

Krenar Xhaferi, drejtor tha se kanalizimi në Mramor është i kontraktuar dhe një segment i tij do ë vazhdoj edhe për vitin tjetër, që të përmbylлим komplet pjesën e kanalizimit. Po ashtu do ta rregullojm edhe kanalizimin në Rimanishtë dhe në shumë lokalitete të tjera. Rrjeti i ujit është një pikë shumë e ndjeshme për të fshatin Mramor, por ne kemi hasur në disa probleme me ujësjellësin dhe kemi punuar me Ministrin e Ambientit, së bashku me Ministrin e Ekonomisë, e kemi bërë detyrën projektuese për hartimin e fizibilitetit për të gjithë fshatrat e Gollakut. Ne si Komunë duhet me marrë leje prej ujësjellësit nëse dëshirojmë me u kyç në rrjetin e ujësjellësit. Sa i përket rrugëve në Mramor, ne vetëm i kemi planifikuar kemi bërë një investim të vogël dhe kemi qenë në harmoni të plotë me bashkësinë lokale të këti fshati. Po ashtu rrjeti i kanalizimit do të bëhet edhe në Siqevë duke vazhduar prej Bakshisë, në Bërrnicë, Bërrnicë të Poshtme, Bërrnicë të Epërme, për të mbërritur në Siçevë. Në lagjen “Velania” e kemi nënshkruar kontratën për rrugën “1 Tetori”. Te lagja e Muhaxherëve kemi intervenuar në një pjesë për me e hapur at rrugë në drejtim të Policisë dhe të xhamisë, sepse ajo e shkarkon udhëkryqin tjetër që e kemi më poshtë. Rruga “Abedin Dino” do të jet një projekt i madh me shteg, trotuare dhe do të ket ndriçim etj.

Investimet në rregullimin e infrastrukturës rrugore do të bëhen edhe në shumë lokalitete të tjera.

Kryetari Rama, kryetar tha se ne investimet tona i kemi fokusuar edhe në zonat rurale. Në këto zona ka nevojë të zhvillohet biznesi, agroturizmi, turizëm malor, etj, pra ky është fokusi jonë i një zhvillimi të mirëfilltë turistik, ekonomik po ashtu në ndërlidhshmëri me ambientin, për të krijuar kushte më të mira për të gjithë edhe për të krijuar punësim.

Sa i përket planeve rregullative, ekzistojnë planet rregullative, të cilat e kryejnë të njëjtën punë, harta zonale është një sistem tjetër që është imponuar dhe është adaptuar si mënyrë e

zhvillimit apo planifikimit të qytetit, por nuk është diçka që sot po e them se e ndalon zhvillimin e mirëfilltë të kryeqytetit.

Izet Sadiku, drejtor tha se në bazë të informatave të qytetarëve në Bardhosh ka dal se është një numër mbi 10,000 banorë, e në çiftë se numri i banorëve është mbi 10,000 atëherë statuti i një institucionin të kujdesit parësorë kalon nga ambulanca në qendrën e mjekësisë familjare, dhe ne e kemi bërë që një vit qendër të mjekësisë familjare me shërbimin 12 orë.

Qëllimi ynë është që edhe me investimet e tjera që jemi duke i bërë me i rritur shërbimet nëpër lagje jo me i centralizua por me i decentralizuar. Po ashtu së shpejti do të fillojm me renovimin e ambulantës në Mramor dhe brenda një viti do të përfundojmë renovimin e të gjitha institucioneve të kujdesit parësor në kryeqytet.

Lulëzim Fushtica, drejtor tha se sa i përket policisë, policia është e pavarur nga kryeqyteti dhe ne nuk kemi kompetenca direkte, por ne jemi në bashkëpunim të ngushtë, kur bëhet plani i rrezikshmërisë dhe plani i vlerësimit të rrezikshmërisë dhe çdo gjë që është shqetësim dhe brengë e qytetarëve ne e përcjellim tek organet e sigurisë. Sa i përket Parkut të Gërmisë, ne jemi në fazën përfundimtare të hartimit të planit të sigurisë së bashku me Drejtorinë e Parqeve. Për hapjen e një nënstatcioni polior në fshatin Hajvali, jemi duke shikuar vend dhe hapësirë se ku duhet të vendoset. Po ashtu si drejtori do të bëjmë verifikimin e të gjitha ndërtesave të vjetra të cilat paraqesin rrezik.

Jehona Lushaku- Sadriu tha se nga data 1 shtator do të fillojmë me mësimin tërë ditë në 5 shkollat të Prishtinës dhe kjo ka të bëjë me rritjen e volumit të lëndëve që kanë të bëjnë me sportin dhe me aktivitetet kulturore, por edhe ngritjen e aftësive të nxënësve për t'i kuptuar tekstet më shumë.

Bekim Brestovci, drejtor tha se kërkesat për ashensor janë përtej të gjitha mundësive që me i pajisur të gjitha objektet me ashensor, mirëpo ne e kemi përpiluar një listë e cila është e përbërë prej disa kriterëve. Sa i përket mbledhjes së mbeturinave në zonat rurale, nuk pajtohem asesi nëse ka raste të tilla, të shtyhet pastaj grumbullimi i mbeturinave për një javë. Sa i përket semaforëve jemi duke punuar intenzivisht për vendosjen tyre. Po ashtu jemi të fokusuar në mbarëvajtjen e rregullt të trafikut urban në të gjitha lagjet e qytetit sidomos në zonat rurale, si dhe jemi të fokusuar në shtrirjen e rrjetit të rrugëve.

Bardh Krasniqi, drejtor tha se ne si drejtori jemi duke i shqyrtua kërkesat që janë adresuar kryesisht për rregullimin e fushave të sportit, këndin e lojrave në disa zona rurale etj. Kryeqyteti ka shumë klube të ndryshme sportive dhe ne si Drejtori e Sportit kemi nda një buxhet dhe i kemi përkrahur.

Debati publik përfundoi në orën 12.20.



Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i debatit
Osman Bllaca

Faqe8nga8

DISKUTIMI PUBLIK ME QYTETARËT E KOMUNËS SË PRISHTINËS

25.06.2024, Prishtinë

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Adresa	Email & Telefon	Nënshkrimi
1	Vileta HASANI			
2	Xhemail Leta			
3	Xhemalif Loxholl			
4	Skender Sylejmanov			
5	Almet Stedorei			
6	Beqir BERISHA			
7	ZIJAT BERISHA			
8	Mervet Selimi			
9	SABRI MUSSELI			
10	ISMET HAZIRI			
11	SENDER MEHMETI			
12	Don Aliu			
13	BERLIN MEHMETI			
14	EGON GASHI			
15	Alim Gashi			
16	Rahim Gashi			
17	Blerina Shala			
18	NEXHAJ QASHI			

B

19	Bakheem Gokur
20	Papip Satoli
21	Geviz Lutale
22	DOKAGON VOKSHI
23	Bumi Kuningi
24	BASHIH GASHI
25	ASTRIT HYJENI
26	JAKUP MEHMETI
27	Ali BEERISHA
28	Beim Hamiti
29	FALUH GASHI
30	Best Peshke
31	ASTRIT GASHI
32	FERIZ KRASHIDI
33	IBRAHIM COOP
34	
35	
36	
37	
38	
39	
40	